



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmjen / Predato Received / Delivered	01.02.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	466/2022		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.34/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.34/2022 të datës 18.01.2021 e parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit/Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.34/2022 e datës 18.01.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Këshilli Prokurorial i Kosovës më datë 22.12.2021 ka shpallur konkursin për pozitën “Zyrtar Administrativ” në Njësinë për Shqyrtimin e Performances së Prokurorisë, në të cilin ka aplikuar edhe ankuesja. Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i themeluar me Vendimin DPSKPK/05/2022 të datës 06.01.2022 respektivisht me Vendimin DPSKPK/12/2022 të datës 17.01.2022, ka shqyrtuar aplikacionet e kandidatëve në këtë rast edhe të ankueses, ku më datë 13.01.2021 ka përgatitur listën e shkurtër, ndërsa sipas njoftimit të datës 13.01.2022 ankuesja nuk është përfshirë në listën e shkurtër.

Ankuesja më datë 14.01.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin Prokurorial të Kosovës/Departamentin për Burime Njerëzore dhe Komisionin Përzgjedhës të Shërbimit Civil.



Burimet Njerëzore të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 17.01.2022 kanë njoftuar ankuesen se Komisioni Përzgjedhës ka refuzuar ankesën e datës 14.01.2022 duke e refuzuar aplikacionin e për arsye që aplikacioni ka qenë i pa kompletuar, ndërsa ankuesja në po të njëjtën ditë ka njoftuar që ka pranuar njoftimin nga Burimet Njerëzore.

Ankuesja kundër këtij njoftimi, më datë 18.01.2022 përmes emailit ankesa.kpmschk@rks-gov.net ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar më numër të ankesës A.nr.34/2022 dhe Nr. prot: 205/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, 24.01.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Këshillin Prokurorial të Kosovës. Këshilli Prokurorial i Kosovës më datë 28.01.2022 ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:205/2022 të datës 18.01.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 18.01.2022 të ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 24.01.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 28.01.2022; Aplikacionin për punësim të ankueses me dokumentet e tjera relevante; Vendimin DPSKPK/05/2022 të datës 06.01.2022 dhe Vendimin DPSKPK/12/2022 të datës 17.01.2022 për themelimin të Komisionit Përzgjedhës; Emailin e datës 19.01.2022 dhe 18.01.2022 nga Sh.H për S.Gj; Emailin e datës 17.01.2022 dhe 06.01.2022 nga S.Gj për K. E; Raportin mbi përgatitjen e listës së shkurtër i datës 13.01.2022 dhe 18.01.2022; Listën e ngushtë të datës 11.01.2022 dhe 18.01.2022; Njoftimin i kandidatëve të përzgjedhur në listën e ngushtë të datës 13.01.2022; Regjistri i aplikacioneve të pranuar; Emailin e datës 17.01.2022 nga ankuesja për Burimet Njerëzore; Emailin e datës 17.01.2022 nga Burimeve Njerëzore për ankuesen; Ankesën e datës 14.01.2022 nga ankuesja për Këshillin Prokurorial të Kosovës/Departamentin për Burime Njerëzore dhe Komisionin Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Konkursin e datës 22.12.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e palejuar, sepse:**

Bazuar në provat e lëndës, Këshilli Prokurorial i Kosovës më datë 13.01.2022 ka bërë publikimin e njoftimit për kandidatët të përzgjedhur në listën e ngushtë, në bazë të të cilit ankuesja nuk është përfshirë në listën e shkurtër për pozitën "Zyrtar Administrativ" në Njësinë për Shqyrtimin e Performances së Prokurorisë, ndërsa ankuesja më datë 14.01.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin Prokurorial të Kosovës/Departamentin për Burime Njerëzore dhe Komisionin Përzgjedhës të Shërbimit Civil, kurse Burimet Njerëzore të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 17.01.2022 kanë njoftuar ankuesen se Komisioni Përzgjedhës ka refuzuar ankesën e datës 14.01.2022 duke e refuzuar aplikacionin e për arsye që aplikacioni ka qenë i pa kompletuar, ndërsa ankuesja në po të njëjtën ditë ka njoftuar që ka pranuar njoftimin nga Burimet Njerëzore.



Ankuesja kundër njoftimit të datës 17.01.2022 të Burimeve Njerëzore të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, konstaton se ankuesja kundër njoftimit të datës 17.01.2022 të Burimeve Njerëzore të Këshillit Prokurorial të Kosovës, fillimisht është dashur që të parashtrojë ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Këshillit Prokurorial të Kosovës, siç parashihet me nenin 80 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“Procedurat për zgjidhjen e kontesteve jashtë gjyqësorit përdoren për zgjidhjen e konflikteve, të cilat mund të zgjidhen me anë të masave të brendshme administrative”*, sepse procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, siç parashihet me 81 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e pastaj varësisht nga vendimmarrja e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Këshillit Prokurorial të Kosovës, ankueses i ka rrjedh afati për parashtrim të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në këtë rast meqenëse nuk ka asnjë dëshmi që ankuesja ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Këshillit Prokurorial të Kosovës, atëherë sipas Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankesa e ankueses e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është e paraafatshme dhe në kundërshtim me nenin 80 paragrafi 1 nën paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *“Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t’i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe”*.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.34/2022, datë 01/02/2022

Avdyll BEKTESHI


Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- ❖ Ankueses
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së